



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



Datë: 26.08.2023
02 Nr.400/01-22401/23

PROCESVERBAL

**Dëgjimi Buxhetor në Brod, me banorët e fshatrave Brod, Baçkë,
Dikancë**

I mbajtur më 26.08.2023, e shtunë, duke filluar nga ora 17:00

VENDI: Shkolla fillore e fshatit Brod

Njoftimi për këtë Dëgjim Buxhetor është publikuar:

Në uebfaqe zyrtare të Komunës më 17.08.2023:

Shqip: <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/08/Degjimi-Brod.pdf>

Boshnjakisht: <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/08/Rasprava-Brod-2.pdf>

Në Facebook-un zyrtar më 20.08.2023:

Shqip: <https://www.facebook.com/photo.php?fbid=641886638040523&set=pb.100066575766996.-2207520000&type=3>

Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/photo/?fbid=641887171373803&set=pb.100066575766996.-2207520000>

Në këtë takim nga Kabineti i Kryetarit të Komunës morën pjesë:

1. Bexhet Xheladini - Kryetar
2. Qamil Kolloni – Drejtor për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim
3. Bean Hadziasan – Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Ambientit
4. Fari Kolloni – Zyrtar për Informim

Pjesëmarrës në këtë dëgjim buxhetor kanë qenë gjithsej 18 persona, të cilët janë nënshkruar në Listën e pjesëmarrësve. Prej tyre kanë qenë:

1. Femra: 0
2. Meshkuj: 18

Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës së Dragashit, Bexhet Xheladini

Bexhet Xheladini: Përshëndetje për të gjithë pjesëmarrësit! E vlerësoj prezencën tuaj në këtë dëgjim buxhetor. Është obligimi ynë si ekzekutiv që ta prezantojmë para jush projekt-buxhetin për vitin 2024, ndërsa prezenca juaj këtu është përmbushje e një obligimi moral e qytetar. Këtë vit buxheti është më i madh se vitin e kaluar. Pas këtyre dëgjimeve buxhetore, ku do t'i marrim kërkesat dhe sugjerimet e juaja, në shtator do ta finalizojmë draft-buxhetin dhe do t'ia paraqesim Asamblesë Komunale për miratim. Pjesa më e rëndësishme e buxhetit për ne është ajo e investimeve kapitale. Këtë vit do të kemi më pak ndarje buxhetore nëpër fshatrave, për shkak se shumica e buxhetit do të destinohet për projektin e Ujësjellësit kryesor, dhe një pjesë tjetër për ndërtimin e fabrikës së ujit. Me ardhjen në pushtet e kemi ritenderuar projektin e Ujësjellësit, pa ndryshime. Ky rrjet do të kushtojë afërsisht 2.5 milionë euro.

Qamil Kolloni, drejtor për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim prezanton para të pranishmëve Listën preliminare të shpenzimeve kapitale të parapara për vitin 2024.

Kërkesat e qytetarëve

Shefket Ismaili, banor i fshatit Brod:

- Rregullimi i përroit të fshatit Brod.

Beadin Azafce – banor i fshatit Brod:

- Rregullimi i kanalizimit në fshatin Brod.

Lista e nënshkrimeve të pjesëmarrësve në dëgjim buxhetor dhe fotografitë

